



VENDIM

Nr. 162 Datë 30.12.2011

PËR

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT TARIFOR TË LIDHUR
NË TENSION NË LARTË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Vendimit nr. 80, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s,

Vendosi :

1. Çmimi i shitjes me pakicë të energjisë elektrike për Klientët Tariforë të lidhur në Tension të Lartë, do të jetë çmimi i përcaktuar në vendimin nr. 100 date 07.12.2010, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10485, datë 26.11.2011.”Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar.
2. Çmimi i energjisë elektrike për energjinë e furnizuar në periudhën e pikut do të jetë 15% më i lartë se ai i furnizuar në periudhën jashtë pikut.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e CEZ Shpërndarje sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI

